

REGJISTRI KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE - SHKURT 2024

NR. RENDOR	DATA E KËRKESËS	OBJEKTI I KËRKESËS	DATA E PËRGJIGJES	PËRGJIGJE	MËNYRA E PËRFUNDIMIT TË KËRKESËS	TARIFA
1	01.02.2024	Kërkesë për informacion dhe dokumentacion mbi një leje të lëshuar nga KKT	26.06.2024	Në përgjigje të shkresës suaj, në të cilën kërkoni të informoheni nëse KKT ka miratuar më herët leje zhvillimi për projektin në fjalë, ju sqarojmë si më poshtë vijon; Pas verifikimit të kryer, nuk rezultoi të ketë vendimmarrje tjetër për projektin në fjalë.	E plotë	Nuk ka

2	07.02.2024	Kërkesë për informacion mbi PDZRK	19.02.2024	<p>Në përgjigje të shkresës tuaj, ju bëjmë me dije si më poshtë vijon: Referuar nenit 16, pika 3, të Ligjit Nr.107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, shprehimisht thuhet:</p> <p>3. AKPT-ja, kryesisht ose me kërkesë të një ministrie apo të një organi tjetër qendror ose vendor, ndërmerr nismën dhe i propozon për miratim KKT- së përcaktimin e një çështjeje, zone ose objekti si të rëndësisë kombëtare në planifikim. Procedurat e detajuara për këtë nismë përcaktohen në rregulloren e planifikimit. Ndërkohë, në zbatim të nenit 36, pika 2 të Vendimit Nr. 686, datë 22.11.2017 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullore së planifikimit të territorit”, i ndryshuar citohet:</p> <p>2. Dokumenti i nismës hartohet nga Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit, në bashkëpunim me ministrinë përgjegjëse për zonën e rëndësisë kombëtare dhe aktorët iniciues. Për sa më sipër, lidhur me informacionin e kërkuar, duhet ti drejtoheni Agjencisë Kombëtare të Planifikimit të Territorit.</p>	E plotë	Nuk ka
---	------------	-----------------------------------	------------	--	---------	--------

3	12.02.2024	Kërkesë për informacion për leje ndërtimi në zonën kadastrale ...	20.02.2024	Në përgjigje të shkresës suaj, në të cilën kërkonti të informoheni lidhur me pasurinë.. ju sqarojmë si më poshtë vijon;Pas verifikimit të kryer, rezulton se për objektin që kërkohet informacion nga ana juaj, Shoqëria ..., në cilësinë e aplikuesit të autorizuar, ka aplikuar për leje zhvillimi për objektin..Agjencia pas verifikimit të dokumentacionit tekniko ligjor, ka marrë vendim refuzimi, duke qënë se zhvillimi propozuar nuk respekton kategorinë e lejuar të përdorimit të tokës, sipas PPV Bashkia Durres.	E plotë	Nuk ka
4	21.02.2024	Kërkesë për vlerësim PPV	07.03.2024	Deleguar Agjencise Kombetare te Planifikimit të Territorit	E plotë	Nuk ka
5	23.02.2024	Kërkesë për informacion	27.02.2024	Në përgjigje të kërkesës Suaj, ju bëjmë me dije si vijon: Agjencia e Zhvillimit të Territorit, në bazë të Ligjit Nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar është autoritetet përgjegjës për zhvillimin e territorit si dhe kryen funksionet e sekretariatit teknik të Këshilli Kombëtar të Territorit. Për sa më sipër, si dhe referuar kërkesës Suaj, ju konfirmojmë se nga verifikimi i kryer, nga shtatori i vitit 2015 (periudhë në të cilën AZHT ka filluar të ushtrojë funksionet e saj), e deri në momentin e lëshimit të kësaj shkrese, nuk është paraqitur asnjë aplikim për miratim leje zhvillimi/ndërtimi nga KKT-ja, brenda sipërfaqes që keni evidentuar në kërkesën Tuaj	E plotë	Nuk ka